



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 167, datë 03.11.2023

**PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË NXËNËSVE ME ARRITJE TË SHKËLQYERA  
TË BASHKISË DURRËS**

Në zbatim të nenit 8, nenit 9, pika 1/1.1 shkronja “b”, nenit 54, nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenit 28 pika 4 shkronja “b” të Ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, si dhe sipas Relacionit të Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Të ofroj mbështetjen financiare për nxënësit me arritje të shkëlqyera, banorë të Bashkisë Durrës, që ndjekin arsimin e mesëm të ulët (AMU) dhe arsimin e mesëm të lartë (AML) në shkollat publike të Bashkisë Durrës, për nxënësit fitues të 3 vendeve të para në olimpiada dhe konkurse ndërkombëtare që zhvillohen dhe i takojnë ciklit AMU, si dhe për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë, fitues të tre vendeve të para, në olimpiadat kombëtare të zhvilluara në vitin paraardhës, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.
2. Miratim e mbështetjes financiare:
  - a) Në masën 30’000 lekë për nxënësit me arritje të shkëlqyera që ndjekin arsimin e mesëm të ulët (AMU) të shkollave 9-të vjeçare publike të Bashkisë Durrës që kanë përfunduar këtë cikël me të gjitha 10 (dhjeta) si dhe provimet e lirimimit me notën 10 (dhjetë).

- b) Për nxënësit fitues të 3 vendeve të para në olimpiada dhe konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare që zhvillohen dhe i takojnë ciklit AMU, si më poshtë vijon:
- Për vendin e parë në masën 40.000 lekë
  - Për vendin e dytë në masën 35.000 lekë
  - Për vendin e tretë në masën 30.000 lekë

3. Miratimin e mbështetjes financiare:

- a) Në masën 100'000 lekë, për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë (AML), fitues të medaljeve të Arta, banorë të Bashkisë Durrës.
- b) Në masën 70'000 lekë, për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë (AML), të listuar në 100 më të mirët e maturës shtetërore për vitin akademik paraardhës, banorë të Bashkisë Durrës.
- c) Për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë (AML), fitues të tre vendeve të para në olimpiadat kombëtare të zhvilluara në vitin paraardhës, si më poshtë vijon:
- Për vendin e parë në masën 50.000 lekë
  - Për vendin e dytë në masën 45.000 lekë
  - Për vendin e tretë në masën 40.000 lekë

4. Për përfitimin e mbështetjes financiare, nxënësit përfitues duhet të dorëzojnë në Drejtorinë e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, pranë Bashkisë Durrës dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Çertifikatë personale e tre muajve të fundit.
- b) Çertifikatë e cila konfirmon vendin fitues të nxënësit, në olimpiada dhe konkurse kombëtare, apo ndërkombëtare sipas cikleve AMU apo AML të studimit.

5. Efektet financiare do të përballohen nga buxheti vjetor i Bashkisë Durrës, sipas programit buxhetor të arsimit për çdo vit buxhetor.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi

**U shpall sot me datë 06.11.2023**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 709 Prot.  
1

Durrës, më 13 / 11 / 2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
Durrës**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.167 datë 03.11.2023  
“Për mbështetjen financiare të nxënësve me arritje të shkëlqyera të bashkisë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016  
“Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

